

Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më **24.04.2014**, pas shqyrtimit të Draft-Statutit për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në territorin e Komunës së Vushtrrisë, duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/09 për transparencë nëpër komuna, si dhe nenit 2 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013, mori këtë:

V E N D I M PËR DHËNIE NË DISKUTIM PUBLIK

Neni 1

Ipet në diskutim publik Draft-Statuti për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Neni 2

Diskutimi publik fillon nga data 25.04.2014 dhe zgjatë deri më 20.05.2014.

Neni 3

Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmer masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna, dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

Neni 4

Obligohet Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale që si hartues dhe propozues i Draft-rregullores në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 2008/09, dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

Gjithashtu DSHPS-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-statutit në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin Maj 2014.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit



Shpëtim Zhegrova



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSQVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 96/14

Nr. i fq. / Br. st - 1 -

Data: / Datum 24. 04. 2014

VUSHTRRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Në bazë të nenit 12.2, pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 41.2 pika "ç" e Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në seancën e mbajtur më 24.04.2014, mori këtë:

V E N D I M PËR RIDESTINIMIN E MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

Me këtë vendim pjesa e mbetur e mjeteve financiare në vlerë prej 8.281,10 € nga kodi i projektit 90260 për ndërtimin e ambulancës në fshatin Duboc në vlerë prej 4.191,5 €, si dhe pjesa e mbetur nga mjetet financiare nga kodi i projektit 90259 për ndërtimin e ambulancës në fshatin Samadrexhë në vlerë prej 4.089,55 € ridestinohen në projektin e ri "instalim i kabllit elektrik dhe pjesëve fazonike" në Qendrën e Mjekësisë Familjare.

Neni 2


Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, si dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Shqipëim Zhegrova



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Në bazë të neneve 30 dhe 31 të Ligjit për Tokën Bujqësore Nr.02/L-26, dt.24.06.2005, neneve 5 dhe 6 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144, dt.22.11.2012, neneve 14.1.2. dhe 17 pika "c" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 40.2 pika "k" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe nenit 3 të Rregullores për Procedurat e Dhënies në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës së Paluajtshme Komunale Nr.19-1/13, dt.31.01.2013, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në seancën e mbajtur më **24.04.2014**, mori këtë:

V E N D I M

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM ME KOMPENSIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS – TOKËS BUJQËSORE DHE KULLOSAT

Neni 1

Me këtë vendim lejohet dhënia me qira e të gjitha tokave bujqësore dhe kullosave në pronësi të Komunës së Vushtrrisë, të konstatuara nga organet gjegjëse.

Neni 2

Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga ky vendim do të rregullohen me kontratë të veçantë konform dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 3

3.1. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Prokurim Publik.

3.2. Drejtoritë e përmendura në paragrafin 3.1. obligohen që t'i zbatojnë të gjitha procedurat e nevojshme ligjore për dhënie me qira të ngastrave kadastrale, ngastrave bujqësore dhe kullosave.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.





Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Në bazë të nenit 12.2 pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, neneve 10, 11 dhe 15 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr.04/L-174, dhe nenit 41.2 pika "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në seancën e mbajtur më **24.04.2014**, mori këtë:

V E N D I M
PËR REVIDIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL NË KOMUNËN E
VUSHTRRISE

Neni 1

Me këtë vendim lejohet revidimi i Planit Zhvillimor Komunal 2009-2014, i cili përfshin Planin për Zhvillimin e Zonave Urbane dhe Rurale në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Neni 2

Plani Zhvillimor Komunal përfshin periudhën kohore 2014-2022 me mundësi vazhdimi.

Neni 3

Obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që të ndërmer masat e nevojshme për implementimin e këtij vendimi në pajtim me ligjet dhe aktet tjera në fuqi, të cilat e rregullojnë këtë çështje.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.





Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Në bazë të nenit 12.2 pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, neneve 10, 11 dhe 15 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr.04/L-174, dhe nenit 41.2 pika "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në seancën e mbajtur më **24.04.2014**, mori këtë:

V E N D I M
PËR HARTIMIN E PLANIT PËR KONSERVIM DHE ZHVILLIM PËR ZONËN E
VJETËR TË QYTETIT TË VUSHTRRISË

Neni 1

Me këtë vendim bëhet hartimi i Planit të Konservimit dhe Zhvillimit për Zonën e Vjetër të qytetit në Komunën e Vushtrrisë. Në këtë plan do të përfshihen vetëm objektet e karakterit të trashëgimisë kulturore dhe historike.

Neni 2

Obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që të ndërmerë masat e nevojshme për implementimin e këtij në pajtim me ligjet dhe aktet tjera në fuqi të cilat rregullojnë këtë çështje.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit



Shpëtim Zhegrova



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Në bazë të nenit 12.2 pika "d" dhe nenit 40.2 pika "c" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 41.2 pika "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe Vendimit të KK-së Nr.222/13, dt. 26.09.2013 për aprovimin e buxhetit të Komunës së Vushtrrisë, KAB-it dhe listës së projekteve prioritare për vitin 2014, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në seancën e mbajtur më **24.04.2014**, mori këtë:

V E N D I M
PËR SHPËRNDARJEN E MJETEVE NGA FONDI PËR TRANSFERE DHE
SUBVENCIONE

Neni 1

Me këtë vendim mjetet buxhetore të komunës – fondi për transfere dhe subvencione për aktivitete kulturore, rinore dhe sportive për vitin 2014, nga vlera totale prej 29,375.00 € të shfrytëzohet shuma prej 1,400.00 € (një mijë e katërqind euro) për aktivitetin sportiv "Studimja 99", të organizuar nga Klubi i Shahut "Llamkos" nga Vushtrria.

Neni 2

Mjetet në shumën e cekur në nenin 1 të këtij vendimi do të ndahen në bazë të kriterëve të përcaktuara me Rregulloren për Përcaktimin e Kriterëve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione për Ndihmë Momentale Entiteteve Publike dhe Jopublike Nr.37-2/11, dt.24.02.2011, si dhe pas dorëzimit të raportit nga përfituesit e këtij fondi për shfrytëzimin e mjeteve nga viti 2013.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit



Shpëtim Zhegrova